



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD

Numri i lëndës: 2023:276576

Datë: 03.04.2024

Numri i dokumentit: 05538709

P.nr.68/2023

### NË EMËR TË POPULLIT

**Gjykata Themelore në Gjilan - Dega në Novobërdë**, gjyqtari i vetëm Sadri Krasniqi, me zyrtares ligjore Donjeta Zenuni, në lëndën penale kundër të akuzuarit, V. R. nga Gjilani, të cilin sipas autorizimit e mbron av.Afrim Salihu nga Prishtina, për shkak të veprës penale: Ndërtim pa leje nga neni 359 paragrafi 2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-së nga Gjilani PP.II.nr.1596/2023, të dt. 19.12.2023, më datë 18.03.2024, në prani të palëve, shpalli dhe komunikoi publikisht, ndërsa më datën 03.04.2024 përpiloi këtë:

### A K T G J Y K I M

I a k u z u a r i :

**V. R.i**, pa pseudonim dhe emër të rrejtshëm, nga i ati R. dhe ëma F.e lindur L., i lindur më datë 06.05.1988, në Gjilan, ku edhe jeton rr. “Femi Agani”, nr.50, me nr.personal 1173373534, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës , ka të kryer fakultetin, i martuar, baba i tre fëmijëve, i punësuar, i gjendjes së mesme ekonomike, sipas deklaratës së tij, nuk ka qenë i dënuar më parë për vepër tjetër penale dhe nuk udhëhiqet procedurë për vepër tjetër penale.

### Ë s h t ë f a j t o r

**Sepse:**

Më dt.23.10.2023, në fshatin Kllobukar, Komuna e Novobërdës, në kompleksin “Anesi”, nga Inspeksioni Ndërtimor i Komunës së Novobërdës është konstatuar se i pandehuri , si pronar i tokës private dhe ndërtues në kundërshtim me nenin 14 dhe 26 të ligjit

të ndërtimit, në ZK Novobërdë, në parcelat kadastrale P-72403031-01943, P-72403031-01944, P-72403031-01945, P-72403031-01946, në vendin e quajtur "Strane" në një sipërfaqe 16.800m<sup>2</sup>, në tokë bujqësore, pa u pajisur me pëlqim për ndryshimin e përhershëm të tokës bujqësore në atë ndërtimore dhe pa leje ndërtimore, ka ndërtuar 30 vila, në kompleksin "Anesi", e cila gjendje faktike është vërtetuar sipas procesverbalit nr.22/23 të dt.23.10.2023 nga Inspektorati Ndërtimor i Komunës së Novobërdës dhe në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e tija të kundërligjshme ka rrezikuar dhe rrezikon sigurinë e përgjithshme që kanë të bëjnë me rregullat elementare të ndërtimit,

-Me çka ka kryer veprën penale, ndërtimi pa leje nga neni 359 par.2 të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4, 38, 42, 43, 44, 69, 70, 71 dhe 72, paragrafi 1, pika 1.5 të KPRK-së, lidhur me nenin 242, 364 dhe 449 të KPRK-së, të akuzuarin V. R. e,

## G J Y K O N

Me dënim kumulativ,

-me dënim me **gjobë** ( të holla) në shumë prej nga **500 € (pesëqind euro)**, të cilën shumë ka për ta paguar duke filluar në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, në të kundërtën i njëjti dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgu, ashtu që për çdo 20 € do t'i llogaritet nga një ditë burgu, dhe

- dënim burgu efektiv në kohëzgjatje prej nga **gjashtë (6) muajve**, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit, e në kuptim të nenit 44 të KPRK-së do t'i zëvendësohet në dënim me gjobë në shumën prej **2200 €**, të cilën shumë, do ta arkëtoi në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, në të kundërtën i njëjti dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim burgu ashtu që për çdo 20 €, do t'i llogaritet nga një ditë burgu.

Pala e dëmtuar, Drejtoria e Inspektoratit komunal në Novobërdë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet i akuzuari, që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 €, krejt këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Njashtu i akuzuari obligohet që në kuptim të nenit 36, paragrafi 3, nën paragrafi 3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, të paguaj shumën prej 20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjiilan, me aktakuzën PP.II.nr.1596/2023, të dt. 19.12.2023, ka kërkuar që ndaj të akuzuarit V. R. nga Gjiilani, të fillohet dhe shtjellohet procedura penale, për shkak të veprës penale: Ndërtim pa leje nga neni 359 paragrafi 2 të KPRK-së, të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata shqyrtoi aktakuzën dhe pas vlerësimit të së njëjtës dhe shkresave tjera të lëndës, konstatoi se e njëjta është e bazuar në ligj, andaj duke vepruar sipas të njëjtës, ka caktuar seancë gjyqësore për shqyrtim fillestar kundër të akuzuarit për datë 18.03.2024, në të cilën seancë gjyqësore pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i akuzuari V. R. i ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet, njëherit thekson se e pranon fajësinë për kryerjen e kësaj vepre penale.

Prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, nuk e kundërshton pranimin e fajësisë, njëherit thekson se janë plotësuar kushtet ligjore për pranimin e fajësisë nga i akuzuari përkitazi me veprën penale me të cilën akuzohet sipas aktit akuzues.

Gjykata pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar pranimin e fajësisë, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt, gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë; se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Andaj, duke u bazuar në të cekurat më lartë, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- se i akuzuari V. R. me dashje ka kryer veprën penale, Ndërtim pa leje nga neni 359 paragrafi 2 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për të cilën vepër penale, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor, ngase veprimet e të

njëjtë i përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtën është edhe penalisht përgjegjës.

Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë, gjykata nuk është lëshuar fare në administrimin e provave të propozuara si në aktakuzë, por drejtë është shkuar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, me rastin e paraqitjes së fjalës përfundimtare deklaron se gjatë shqyrtimit fillestar i akuzuari V. R. e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, me pranimin e fajësisë u vërtetua gjendja faktike ashtu siç është përshkruar në dispozitiv të aktakuzës lëndore, me që u vërtetua gjendja faktike, mbetet pranë aktakuzës dhe propozimeve të cilat e njëjta i përmban. Andaj kërkon nga gjykata që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të njëjtin ta dënojë me dënim të paraparë me ligj, duke i marr parasysh të gjitha rrethanat si ato lehtësuese po ashtu edhe ato rënduese, në mënyrë që dënimi i shqiptuar të jetë në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit V.R., av. Afrim Salihu, me rastin e paraqitjes së fjalës përfundimtare deklaron se pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë ashtu siç akuzohet sipas aktit akuzues, duke ia rikujtuar të njëjtë benefitet e pranimit të fajësisë dhe rrethanat e tjera të cilat burojnë nga pranimi i fajësisë. Pas konsultimeve të mjaftueshme me të pandehurin kanë ardhur në përfundim që është e vërtetë ashtu siç është përshkruar në aktakuzë, se ditën kritike inspektorët komunal kanë qenë te i pandehuri i cili edhe është pronar por që nuk ka pasur leje ndërtimore dhe se tani e posedon të gjithë dokumentacionin përkatës për ndërtim. I propozon gjykatës që si rrethana lehtësuese gjykata të ketë parasysh se i pandehuri më parë nuk ka qenë i dënuar për vepër tjetër penale dhe se ndaj tij nuk udhëhiqet asnjë procedurë penale. Andaj i propozon gjykatës që pasi që për këtë vepër penale është paraparë dënim kumulativ me gjobë dhe me burg, nëse gjykata gjen prova dhe i shqipton dënim me burg kërkon që konform nenit 44 të KPRK-së, i njëjti dënim ti zëvendësohet në dënim me gjobë.

I akuzuari V. R. me rastin e paraqitjes së fjalës përfundimtare deklaroi se, e mbështet fjalën e avokatit të tij, e pranon fajësinë dhe veprën penale për të cilën ngarkohet nga prokurorja e shtetit, ka gabuar, është penduar, është hera e parë që ka rënë ndesh me ligjin dhe i premtton gjykatës se më nuk do të kryej këso vepra penale apo të tjera, të tilla, andaj kërkon nga gjykata që ti shqiptojë një dënim sa më të butë konform ligjit.

Gjykata me rastin e vendosjes për llojin dhe lartësinë e dënimit ndaj të akuzuarit për veprën penale të kryer, vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, ndikojnë në shqiptimin e drejtë dhe meritore të dënimit ligjor. Në veçanti për këtë rast si rrethana lehtësuese për të akuzuarin gjykata pati parasysh pranimin e fajësisë nga i njëjti, e këtë e ka shprehur që në fillim të seancës, është penduar, se i njëjti për herë të parë ka rënë ndesh me ligjin dhe se ndaj tij nuk zhvillohet procedurë tjetër penale, si dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej këso vepra apo të tjera penale. Po ashtu gjykata pati parasysh edhe faktin se i njëjti ka bërë ndërrimin e destinimit të tokës, nga toka bujqësore në tokë ndërtimore, pastaj ka parashtruar kërkesë për t'u pajisur me leje ndërtimore, por ende nuk ka marrë përgjigjeje prej organeve kompetente. Ndërsa gjykata nuk ka gjetur ndonjë rrethanë veçanërisht rënduese për të akuzuarin, andaj duke pasur parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, peshën e veprës penale të kryer dhe mënyrën e kryerjes së saj, i ka shqiptuar dënimet si në dispozitiv të aktgjykimit.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimet si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ndaj të akuzuarit V. R. , duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, janë dënime të drejta, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit.

Gjykata, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Pala e dëmtuar, Drejtoria e Inspektoratit komunal në Novobërdë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Duke pasur parasysh natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare të akuzuarit, gjykata, bazuar në nenin 451 paragrafi 1 i KPPRK-së, ka vendosur që të akuzuarin ta detyrojë për ta paguar paushallin gjyqësor në shumën prej 20 € (Njëzetë euro), si dhe 20 € për Programin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kanosje përmbarimi.

Pas shpalljes së aktgjykimit, në kuptim të nenit 367 të KPPRK-së palët janë udhëzuar për të drejtën në ankesë.

Nga të cekurat më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS NOVOBËRD  
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL**

**2023:276576, 03.04.2024**

**G j y q t a r i**

---

Sadri Krasniqi,d.v.

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 (tridhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.